



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRI

Nr. 1650/3 Prot. 1650/3 Tiranë, më 25/03/2019

gjykati i përgjithshëm i përfituar nga e drejtësia

UDHËZIM

Në rastet këtë Drejtori i përgjithshëm i përfituar nga e drejtësia
situatës e përfituar nga e drejtësia

Nr. 2, Datë 25/03/2019

**PËR PROCEDURAT, PERIODICITETIN DHE RREGULLAT PËR VERIFIKIMIN E
RRETHANAVE PËR KTHIMIN E PËRFITIMEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë,” i ndryshuar, si dhe të nenit 31 pika 1 të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

përfituar nga përdorimi i Ndihmës Juridike Falas, duke qenë se subjekti i përfituar ka qenë subjekt i kthimit i bëhet, se përfituar është subjekt i kthimit i bëhet, se përfituar është subjekt i kthimit i bëhet,

U D H Ë Z O J:

1. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon në mënyrë periodike, çdo vit, gjendjen ekonomike dhe financiare të subjekteve përfituese të ndihmës juridike, si dhe fazën në të cilën ndodhet gjyktimi me palë subjektin përfitues.

2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të kryejë verifikim në çdo kohë në rast se ka të dhëna apo indicie për ndryshimin e rrethanave.

3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, pas miratim të ndihmës juridike, u kërkon subjekteve përfituese të nënshkruajnë një deklaratë në të cilën ata marrin përsipër detyrimin për të njoftuar për ndryshimin e rrethanave financiare ose për rastet kur nuk dëshirojnë të ndjekin më tej rrugën gjyqësore, duke pranuar kthimin vullnetar të shumës së përfituar për këtë qëllim.

4. Subjektet përfituese të ndihmës juridike kanë detyrimin që të paraqesin pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas kopje të vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe të urdhrit për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor.

5. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me qëllim mbledhjen e të dhënave i kërkon informacion subjekteve përfituese dhe institucioneve publike dhe jo publike që mund të kenë dijeni lidhur me situatën në të cilën ndodhet subjekti përfitues.

6. Subjekti përfitues konsiderohet se nuk i plotëson më kriteret ligjore për përfitimin e ndihmës juridike me qëllim kthimin e shumës së përfituar në rastet kur:

- a) të ardhurat financiare janë të tillë që nuk e përfshijnë atë në asnjë nga kategoritë e nenit 12 të ligjit nr.111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
 - b) nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë brenda 3 muajve nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë;
 - c) ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit;
 - c) ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta.

7. Në rastet kur Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas konstaton se ndodhet para njërës prej situatave të parashikuara në pikën 6 të këtij udhëzimi merr vendim të arsyetuar, në të cilin pasqyron:

- a) të dhënat e mbledhura prej saj;
 - b) shumën e përllogaritur saktë që duhet të kthehet nga subjekti dhe
 - c) afatin brenda të cilit duhet të kthehet shuma e përfituar, i cili në çdo rast nuk duhet të tejkalojë afatin prej 6 (gjashtë) muaj nga data e konstatimit të rrethanës ndryshuese.

8. Në rast se subjekti përfitues refuzon me veprim ose mosveprim kthimin e shumës së përfituar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i drejtohet me kërkesë gjykatës që ka vendosur për dhëniën e ndihmës juridike, duke i kerkuar kthimin e shumës së përfituar nga subjekti. Kthimi i shumës së përfituar dhe afati i kthimit të tyre, bëhet sipas vendimit të shpallur nga gjykata që përbën titull ekzekutiv.

Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



RELACION PËR PROJEKTUDHËZIMIN

“PËR PROCEDURAT, PERIODICITETIN DHE RREGULLAT PËR VERIFIKIMIN E RRETHANAVE PËR KTHIMIN E PËRFITIMEVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTUDHËZIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektudhëzimi synon të përcaktojë procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve për efekt të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” (në vijim ligji nr. 111/2017”). Nevoja e hartimit të këtij projektudhëzimi vjen si rezultat i kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 111/2017.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME, RISITË

Akti synon të caktojë procedurat, periodicitetin dhe rregullat që duhet të ndjekë Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për verifikimin e rr Ethanave për kthimin e shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin për përbushjen e këtij detyrim, nga subjekti përfitues i ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Ligji nr. 111/2017 parashikon se në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rr Ethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i njofton përfituesit të ndihmës juridike detyrimin për kthimin vullnetar të shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin për përbushjen e këtij detyrimi.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektudhëzimi i propozuar mbështetet në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikë 1 të nenit 31 të ligjit nr.111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTUDHËZIMIT

Projekt udhëzimi përbëhet nga 8 pika.

Në pikën 1 të udhëzimit parashikohet se Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas verifikon në mënyrë periodike, të paktën një herë në 2 vjet, gjendjen ekonomike dhe financiare të subjekteve përfituese të ndihmës juridike, si dhe fazën në të cilën ndodhet gjykimi me palë subjektin përfitues.

Në pikën 2 të udhëzimit parashikohet se Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të kryejë verifikim në çdo kohë në rast se ka të dhëna apo indicie për ndryshimin e rrethanave.

Në pikat 3, 4 dhe 5 të udhëzimit parashikohet procedura që ndjek Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, mbi mbledhjen e të dhënya mbi ndryshimin e situatës financiare të subjekteve përfituese, duke përcaktuar edhe dokumentet që duhet të dorëzohen.

Pika 6 e udhëzimit duke iu referuar parashikimeve të ligjit përcakton rastet se kur subjektet përfituese kthejnë shumën e përfituar, të tilla si të ardhurat financiare janë të tilla që nuk e përfshijnë atë në asnjë nga kategoritë e nenit 12 të ligjit nr.111/2017; nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë brenda 3 muajve nga data e miratimit për përfitimin e ndihmës juridike; ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit; ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta.

Pika 7 në vijim të konstatimit të një prej këtyre rasteve, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas merr vendim ku pasqyron: të dhënat e mbledhura; shumën e përllogaritur saktë dhe afatin brenda të cilit duhet të kthehet shuma e përfituar, i cili në çdo rast nuk duhet të tejkalojë afatin prej 6 (gjashtë) muaj nga data e konstatimit të rrethanës ndryshuese.

Pika 8 në rast të refuzimit nga ana e subjektit përfitues të shumës së përfituar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i drejtohet me kërkesë gjykatës që ka vendosur për dhënien e ndihmës juridike, duke i kërkuar kthimin e shumës së përfituar nga subjekti.

V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

VI. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Përgatitja e këtij projektudhëzimi, është realizuar nga Ministria e Drejtësisë me kontributin e ekspertëve të UNDP-së.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)